

## MENDIM PAKICE

Me vendimin nr. 6, datë 30.03.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor (KZGJ) vendosi të rrëzojë padinë e paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë, me të cilën kundërshtoj vendimi i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) nr. 32, datë 23.03.2023 dhe vendimi nr. 178, datë 18.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në cilësinë e një prej gjyqtarëve të caktuar në përbërje të trupit gjykues, parashtoj mendimin tim të kundërt me vendimin e shumicës, që pranoi të shqyrtojë në themel padinë objekt gjykimi. Referuar rrethanave të çështjes dhe padisë së paraqitur, personalisht ndaj mendimin se verifikohet një prej rasteve, kur padia nuk mund të ngrihet dhe për rrjedhojë duhej vendosur pushimi i çështjes.

### *1. Mbi faktet procedurale*

Në kuadër të procesit për regjistrimin e subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, që do të zhvillohen në datën 14 maj 2023, është regjistruar kërkesa për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë” (BF), bazuar ndër të tjera edhe në marrëveshjen e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në koalicion :

- 1) “Partia e Lirisë” (PL);
- 2) “Partia Demokratike e Shqipërisë” (PDSH)
- 3) “Partia Demokratiane e Shqipërisë” (PDK);
- 4) “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ).

Në seancën publike për shqyrtimin e kërkesës, mori pjesë edhe përfaqësuesi i subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, i cili kundërshtoi përfshirjen në marrëveshjen e koalicionit të kësaj partie, duke bërë me dije se nuk ekzistonte një e tillë.

Me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi :

- Regjistrimin e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” (PL – PDK – PBDNJ), si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, me parti pjesëmarrëse të tij si më poshtë :

- a) “Partia e Lirisë” (PL);
- b) “Partia Demokratike e Shqipërisë” (PDK);
- c) “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ).

Duke kundërshtuar procedurën e ndjekur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, si dhe vendimin e marrë prej tij, që lejonte ndër dokumentet për regjistrimin e koalicionit edhe marrëveshjen e paraqitur ku përfshihej Partia Demokratike e Shqipërisë, kjo e fundit paraqiti ankimin administrativ para Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Ankuesi pretendoi se Komisioneri nuk duhej të kish marrë vendimin përfundimtar, para se partitë pjesëmarrëse në koalicion të paraqisnin një marrëveshje të re, që nuk përfshinte PDSH-në. Lejimi i këtij dokumenti zgjedhor, krijonte sipas ankuesit konfuzion gjatë procesit zgjedhor tek zgjedhësit dhe nuk pengonte përdorimin e simboleve të këtij subjekti zgjedhor nga kandidatë apo subjekte, që nuk i përkisnin atij. Për këtë arsye, PDSH i kërkoi KAS-it, që të rregullonte këtë paligjshmëri.

Me vendimin nr. 32, datë 23.03.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosi :

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023, të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”,
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Mospranimi i ankimit u vendos mbi argumentin se ankuesi, subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, nuk kishte interes të ligjshëm lidhur me procedurën për regjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor. Për rrjedhojë, KAS-i refuzoi ta shqyrtojë në themel ankimin e paraqitur.

Në datë 27.03.2023, u depozitua në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, padia e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë me objekt : 1. Shfuqizimin e vendimit të KAS “Për mospranimin për shqyrtim të ankimit”; 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 178, datë 18.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; 3. Plotësimin e të metave nga Partia e Lirisë, duke hequr Partinë Demokratike nga Marrëveshja e Koalicionit.

Ankuesi parashtroi pretendimet e tij lidhur me interesin e ligjshëm, që kishte për të ankimuar në KAS vendimin e mësipërm të Komisionerit, ashtu sikurse paraqiti edhe argumentet lidhur me paligjshmërinë e vendimit të këtij të fundit, i cili sipas ankuesit duhej të urdhëronte paraprakisht paraqitjen e një marrëveshje të re për koalicion, pa Partinë Demokratike dhe më pas të vijonte me regjistrimin e këtij subjekti zgjedhor.

## **2. Dispozitat e zbatueshme**

Neni 12 i Kodit Zgjedhor Përbërja dhe funksionimi i KQZ-së” : “1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor. / 2. Organet drejtuese të KQZ-së janë: a) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve; b) Komisioni Rregullator; dhe c) Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve. ... / 5. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organ kompetent për shqyrtimin e ankimimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor. ... / 7. Veprimtaria e KQZ-së, organeve drejtuese dhe e administratës udhëhiqet, sipas rastit, nga ky ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe nga ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Neni 129 i Kodit Zgjedhor : “1. Për çdo kërkesë ankimore të regjistruar KQZ-ja cakton me short si relator njërin nga anëtarët e saj. Relatori bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës, sipas nenit 126 të këtij Kodi dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të këtij Kodi. Rezultati i verifikimit **relatohet në mbledhjen e KQZ-së jo më vonë se 24 orë** nga çasti i regjistrimit të kërkesës ankimore. / ... 3. KQZ-ja bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore dhe vendos: a) kalimin e kërkesës për shqyrtim; b) **mospranimin e kërkesës për shkak të mungesës së elementeve të përcaktuara në nenin 130 të këtij Kodi; ...**”

Neni 130 i Kodit Zgjedhor “Objekti I verifikimit paraprak” : “KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon elementet e mëposhtme: / ...; b) **legjitimitimin e ankuesit; ...**”

Neni 131 i Kodit Zgjedhor “Përmbajtja e vendimit të pranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore” : *“1. Në vendimin e pranimit për shqyrtim të kërkesës ankimore, KQZ-ja duhet të përcaktojë datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në seancë publike. ... / 2. Seanca e shqyrtimit zhvillohet jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 48 orë nga data e shpalljes së vendimit të pranimit.”*

Neni 145 i Kodit Zgjedhor “E drejta e ankimit në gjykatë” : *“1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. ... 2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.”*

Neni 158 i Kodit Zgjedhor “Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor” : *“... 4. Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim, në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë. ...”*

Neni 299 i Kodit të Procedurës Civile : *“Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ... c) gjykata konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si edhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte. ... .”*

### **3. Vlerësimi lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes dhe padinë e paraqitur për shqyrtim**

Zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë zhvillohen në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor. Për vetë rëndësinë që mbart një proces zgjedhor në jetën e vendit, është ngritur një organ i specializuar për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është pikërisht organi publik i ngarkuar me përgjegjësinë dhe

kompetencën për të ndjekur çdo proces zgjedhor. Po ashtu, organizimi i KQZ-së është i tillë, që edhe ankimet administrative ndaj vendimeve që merren në kuadër të një procesi, i parashikon të zgjidhen nga një prej organeve, që është Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS). Referuar dispozitave të Pjesës X të Kodit Zgjedhor, procedura për shqyrtimin e ankimeve zgjedhore, zhvillohet në afate qartësisht të përcaktuara, çka synon që procesi të mos pengohet dhe mosmarrëveshjet eventuale të zgjidhen sa më shpejt.

Procedura e shqyrtimit të ankimeve nga KAS, ndjek të njëjtat rregulla që janë përcaktuar edhe në Kodin e Procedurave Administrative. Kështu, para shqyrtimit të ankimit, është faza paraprake, në të cilën verifikohen elementet formalë të ankimit si dhe kushtet e pranueshmërisë (shih nenet 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor). Këto të fundit lidhen me : 1. kompetencën e KAS; 2. legjitimitimin e ankuesit; si dhe 3. respektimin e afatit të ankimit. Nëse këto parakushte nuk plotësohen, KAS-i vendos mospranimin e ankimit, duke mos shqyrtuar në themel pretendimin/prendimet e ankuesit. Kjo fazë paraprake e procedurës, duhet të zhvillohet brenda 24 orëve nga paraqitja e ankimit.

Vetëm nëse ankimi shpallet i pranueshëm, KAS-i duhet të caktojë seancën për marrjen e vendimit përfundimtar, jo më vonë se 48 orë nga data e shpalljes së vendimit të pranimit (neni 131 i Kodit Zgjedhor). Në këtë mënyrë përcaktohet në ligj edhe afati për shqyrtimin e ankimit zgjedhor.

Referuar natyrës së vendimit që merr KAS-i, lidhur me një ankim zgjedhor, si dhe rregullave të mësipërme, procedura administrative mund të mbyllet ose me një vendim jo përfundimtar që konsiston në mospranimin e ankimit, ose me një vendim përfundimtar, që zgjidh në themel mosmarrëveshjen, duke e gjetur të bazuar ose jo ankimin e paraqitur për shqyrtim.

Të dyja vendimet që merr KAS-i, janë objekt i kontrollit gjyqësor nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, sipas neneve 145 e vijues të Kodit Zgjedhor. Nga përmbajtja e nenit 145 rezulton se ankimet në Kolegjin Zgjedhor mund të paraqiten si ndaj një vendimi të KQZ-së që cenon interesin e ligjshëm të subjektit zgjedhor ankues, ashtu edhe ndaj mosveprimit të KQZ-së, në rastet kur nuk merret një vendim brenda afateve të caktuara në ligj. Në rastin e parë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor e zgjidh çështjen në themel, duke vlerësuar bazueshmërinë e vendimit që ankimohet. Në të kundërt, në rastin kur KQZ-ja, pavarësisht detyrimit ligjor, nuk ka marrë një vendim përfundimtar, duke refuzuar të shqyrtojë ankimin administrativ, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka kompetencën të

urdhërojë KQZ-në të marrë vendim dhe të caktojë për këtë urdhërim edhe një afat të prerë (neni 148 i Kodit Zgjedhor). Ky vendim i Kolegjit merret në ato raste kur gjen paligjshmëri në veprimtarinë e KAS-it, që konsiston në mosveprimin e tij për marrjen e një vendimi, për çështje në kompetencë të tij.

Në themel të këtij rregullimi qëndron parimi i ndarjes së pushteteve, duke kufizuar kontrollin gjyqësor mbi themelin e mosmarrëveshjes, vetëm për rastet kur vetë organi publik e ka ushtruar kompetencën. Në rastin kur organi publik ka refuzuar në mënyrë të paligjshme të përmbushë përgjegjësitë e veta, kontrolli gjyqësor mjaftohet me evidentimin e kësaj paligjshmërie dhe urdhëron organin të marrë vendim. Kjo zgjidhje ligjore pengon gjykatën të marrë kompetencën e KAS-it, kur ky i fundit nuk e ka ushtruar atë. Nga përmbajtja e nenit 145.2 të Kodit Zgjedhor, parashikohet se rregulli i mësipërm ka pasur edhe përjashtime. Pavarësisht se përjashtimi nga rregulli, referon në përmbajtjen e nenit 24 të Kodit Zgjedhor, që ka ndryshuar tashmë, duke mbajtur në vëmendje dispozitën e mëparshme<sup>1</sup>, rezulton se i vetmi përjashtim nga rregulli për të mos e shqyrtuar çështjen në themel, kur nuk ka një vendim përfundimtar nga KQZ-ja, lidhet me ato vendime që më herët merreshin me shumicë të cilësuar të votave. Kjo do të thotë se në rastin e shqyrtimeve administrative, mund të mos arrihej kuorumi i caktuar në ligj, ndaj KQZ-ja praktikisht ishte në pamundësi për të marrë një vendim përfundimtar, gjë që justifikon ligjërisht kalimin e çështjes në juridiksionin gjyqësor të Kolegjit Zgjedhor. Aktualisht, me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, kur vendimmarrjet e KQZ-së nuk kushtëzohen në asnjë rast me një shumicë të cilësuar votash në favor të vendimit, praktikisht çon në përfundimin se në asnjë rast Kolegji Zgjedhor nuk mund të marrë kompetencën e KAS-it, por vetëm të kontrollojë ligjshmërinë e veprimtarisë së tij, përfshirë këtu edhe aktin administrativ me të cilin vendoset mospranimi i

---

<sup>1</sup> Neni 24 i Kodit Zgjedhor para ndryshimeve “Vendimmarrja në KQZ” : 1. *Konsiderohen të miratuara, kur votojnë “pro” jo më pak se 5 anëtarë të KQZ-së, vendimet lidhur me: a) shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, sipas neneve 162, 163 dhe 166, pika 3 të këtij Kodi; b) pranimin e ankimit kundër vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve të zonës zgjedhore, sipas nenit 123 të këtij Kodi dhe vendimet lidhur me ankimet kundër vendimeve të KZAZ-ve për rezultatin e zgjedhjeve për qeverisjen vendore; c) kërkesat për deklarimin e pavlefshëm të zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi; ç) shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore apo në të gjithë vendin dhe përsëritjen e tyre; ...”*

ankimit. Ky vendim jo përfundimtar, që kufizon të drejtën e ankimit, mund të shpallet i paligjshëm nga gjykata, e cila mund të arrijë në përfundimin se ankimi është i pranueshëm, rast në të cilin gjykata vlerëson se ankimi i paraqitur, do të duhet të vijojë me fazën tjetër, atë të procedurës për shqyrtimin e tij dhe marrjen e një vendimi përfundimtar.

Duke i'u kthyer rastit në shqyrtim, rezulton se mosmarrëveshja e referuar pranë KAS-it nga Partia Demokratike e Shqipërisë nuk u shqyrtua në themelin e saj dhe procedura administrative u mbyll pa një vendim përfundimtar. KAS-i vlerësoi se ankimi i paraqitur nuk plotësonte kushtet e pranueshmërisë për mungesë të legjitimitetit të subjektit zgjedhor ankues, ndaj vendosi mospranimin e tij.

Në vijim, subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë nuk u pajtua me vlerësimin e KAS-it, lidhur me mos legjitimitetin, duke pretenduar në të kundërt se, jo vetëm kishte interes të ligjshëm lidhur me procedurën e regjistrimit të subjektit zgjedhor koalicionit "Bashkë Fitojmë", por edhe se kishte arsye të bazuara për të gjetur shkelje të ligjit në vendimin e marrë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbi bazën e pretendimit të mësipërm u paraqit edhe padia objekt shqyrtimi, e cila u shoqërua me kërkimin që Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, përpos cilësimit të paligjshëm të vendimit të KAS-it lidhur me legjitimitetin, të vendoste edhe për themelin e mosmarrëveshjes, që do të thotë se Kolegji Zgjedhor Gjyqësor do të duhej, sipas paditësit, të shqyrtonte pretendimet që ishin ngritur para KAS-it, por që nuk ishin shqyrtuar prej tij.

Për të qartësuar qëndrimin e palës paditëse, në seancën gjyqësore të zhvilluar nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, u pyet përfaqësuesi i saj lidhur me pritshmërinë e palës paditëse për vendimin gjyqësor që synohej të merrej. Përfaqësuesi i palës paditëse parashtroi se kërkohej pikërisht zgjidhja në themel e pretendimeve mbi pabazueshmërinë e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pavarësisht se këto pretendime nuk ishin shqyrtuar nga KAS-i.

Në kushtet e mësipërme, vlerësoj se subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, e cila pretendoi se nga veprimtaria e KQZ-së ishin cenuar interesat e saj të ligjshme,

- kishte të drejtën e ngritjes së padisë në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, kundër vendimit për mospranimin e ankimit;
- shkak i padisë lidhet me cenimin e së drejtës për ankim ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe mospranimin për shqyrtim të ankimit nga KAS;
- rivendosja e së drejtës së cenuar do të mund të kryhej, nëpërmjet kontrollit gjyqësor të ligjshmërisë së vendimit për mospranimin e ankimit;
- nëse Kolegji Zgjedhor Gjyqësor do të vlerësonte të drejtë pretendimin mbi legjitimitetin, do ta shfuqizonte këtë vendim dhe, duke deklaruar të pranueshëm ankimin administrativ, do të duhej të kish urdhëruar KAS-in të merrte vendim përfundimtar brenda një afati të caktuar me orë.

Ndryshe nga sa më sipër, pala paditëse i kërkoi Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor ta zgjidhë çështjen në themel, nëpërmjet shfuqizimit të vendimit të KAS dhe të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe plotësimin e të metave, për heqjen e Partisë Demokratike nga Marrëveshja e Koalicionit, duke shmangur në këtë mënyrë kompetencën e KAS-it, që është organi publik i ngarkuar me ligj për shqyrtimin e ankimeve zgjedhore, si dhe duke injoruar kufizimin e kompetencës së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në rastin kur KQZ-ja nuk e ka marrë një vendim.

Si përfundim mosmarrëveshja e lindur mes palës paditëse dhe KAS-it, kishte si shkak ligjor cenimin e aksesit nëpërmjet mbylljes së procedurës administrative pa një vendim përfundimtar, çka legjitimonte Partinë Demokratike të Shqipërisë t'i kërkonte Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, të detyronte KAS-in që ta merrte një vendim të tillë.

Paraqitja e një padie sipas objektit të sipërcituar, me të cilën u kërkua ushtrimi i kompetencës së KAS-it, nga Kolegji Zgjedhor, e cilëson atë si një padi që nuk mund të ngrihet, pasi çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, ndaj në bazë të nenit 299, shkronja c) të Kodit të Procedurës Civile, duhej të vendosej pushimi i gjykimit.

**Tiranë, 30.03.2023**

**GJYQTARE**

**Edlira PETRI**